




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 158/24
Data. 23.02.24



Prishtinë, 29 janar 2024
Kodi i ZRRE-së: V_1872_2024

Bordi i Zyrës së Rregulatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenit 15 , Nenin 25, Nenit 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 28, Paragrafi 1.24 dhe 1.25 të Ligji për Energjinë Elektrike (Nr. 05/L – 085);
- Dispozitat e Nenit 14.2 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;
- Kërkesën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS SH.A.), të datës 24.11.2023 për shqyrtim dhe aprovim të Planit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve për vitin 2024,

në seancën e mbajtur me datë 29 janar 2024, nxori këtë:

VEN DIM

- I. **APROVOHET** - Plani i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve për vitin 2024.

Arsyetim

- o Zyra e Rregulatorit për Energji (në tekstin e mëtejme ZRRE) me datë 24.11.2023 ka pranuar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (në tekstin e mëtejme: OSSH), kërkesën për aprovim të Planit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve për vitin 2024.
- o Plani i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve për vitin 2024, paraqet planin vjetor të zvogëlimit të humbjeve totale të OSSH-së në pajtim me cakun e reduktimit të humbjeve dhe lakores së humbjeve të lejuara për Periudhën e Tretë Rregullative nga ZRRE, si dhe në pajtim me Planet Zhvillimore dhe Investive të OSSH-së.
- o Qëllimi kryesor i Planit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve për vitin 2024 është që, të projektojë planin e veprimit për zvogëlimin



e humbjeve, përmes investimeve kapitale dhe optimizimit të operimeve, si dhe pritshmërinë e zvogëlimit të humbjeve përgjatë vitit 2024.

- ZRRE, në përputhje me Nenin 27 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, me datë 1 dhjetor 2023, ka vendosur në konsultim publik dokumentin, Planin i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve për vitin 2024, duke ju ofruar mundësinë të gjitha palëve të interesit të ofrojnë komentet e tyre brenda 15 ditëve nga data e publikimit.
- ZRRE, pas analizimit dhe vlerësimit të Planit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve për vitin 2024 dhe pas përfshirjes së komenteve ka vlerësuar se i njëjti është në pajtueshmëri me kërkesat ligjore dhe i harmonizuar me caqet e vendosura nga ZRRE përmes Vendimit V_1636_2022 për Cakun e Reduktimit të Humbjeve për Periudhën e Tretë Rregullative, të cilat pritet që në fund të vitit 2024 të arrijnë në 14.70%.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit dhe shqyrtimit Planit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve për vitin 2024 duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

II. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.



Vendimit i bashkëngjitet:

- Plani i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për Menaxhimin dhe Reduktimin e Humbjeve për vitin 2024.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues,

Lutfije Dervishi, anëtar

Gani Buçaj, anëtar

Arta Isufi, anëtar

Adnan Preniqi, anëtar

Vendimi i dërgohet:

- KEDS Sh.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji